



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.____.2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik: “InfoSoft Office” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **J62426002Q**

Adresa: Tiranë, Kashar, Kodër Kashar, Autostrada Tirane - Durres, Km 8.

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për Propozim - Mallra”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: **REF-87931-02-22-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje kancelari”, me fond limit: **1 033 052** (një milion e tridhjetë e tre mijë e pesëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH**, nga **grandi në vlerën: 583 333** (pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH** dhe nga të ardhurat në vlerën: **449 719** (katërqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH**, me afat realizimi: **10** (dhjetë) **ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikime të mëparshme: nuk ka patur

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 29, datë 01 Mars 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatorin Ekonomik: “InfoSoft Office” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **J62426002Q**
Vlera: **798 630.6** (shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë pikë gjashtë) **lekë pa TVSH**
2. Operatorin Ekonomik: “LIBRARI DYRRAHU” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **L91418502J**
Vlera: **818 818** (tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH**
3. Operatorin Ekonomik: “EUROPRINTY GROUP” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **L21621001I**
Vlera: **866 000** (tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) **lekë pa TVSH**
4. Operatorin Ekonomik: “Adenis Kastrati” P. Fizik, me numër Nipt-i: **L51611004I**

Vlera: **888 000** (tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH

5. Operatorin Ekonomik: “**MARKETING & DISTRIBUTION**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J72124001N**

Vlera: **1 028 920** (një milion e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSH

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatorin Ekonomik: “**LIBRARI DYRRAHU**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L91418502J**
2. Operatorin Ekonomik: “**EUROPRINTY GROUP**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L21621001I**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

- ❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “**LIBRARI DYRRAHU**” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/Kualifikimit, si më poshtë:

- I. **Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit:**

“Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.”

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në *Deklaratën mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme sipas shtojcës 5* nuk është plotësuar pika 3 e deklaratës ku duhet të deklaronte se: *Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ etj., nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.*

- II. **Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “b”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**
“b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 2/1;...”

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në *Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur* janë klikuar të 2 (dy) opsionet e pikës 6 të kësaj deklarate, kur operatori ekonomik është i vetëm si pjesëmarrës.

- III. **Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.1.1/ 2.1 Për kapacitetin ligjor/ profesional i operatorëve ekonomikë:/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë ISO 9001. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/ mallrave/ shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas aktmarrëveshjes

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se Certifikata ISO 9001: 2015 e paraqitur, është në gjuhën angleze, dhe jo e përkthyer, noterizuar.

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.1/ 2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:/
2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilanceve, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme (2017, 2018, 2019).

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se bilanci i viti 2019 nuk është i konfirmuar me vulë pranë autoriteteve tatimore.

V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.2/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një numër minimal prej 2 (dy) punonjësish të punësuar, ndër të cilët 1 (një) shofer dhe 1 (një) punonjës për transportin e mallit, të cilët duhet të rezultojnë në listëpagesa për periudhën 3 (tre) muajt e fundit, për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqesë: Vërtetim lëshuar nga organet tatimore, listëpagesat e deklaruar përmes formës elektronike ku të jetë i specifikuar numri i punonjësve për çdo muaj, si dhe leje për drejtimin e mjetit kategoria B, të punonjësit me detyrë “shofer”.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka paraqitur listëpagesat për 3 (tre) muajt e fundit, konkretisht listëpagesën e muajit Dhjetor 2020.

- ❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “EUROPRINTY GROUP” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.1/ 2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:/
2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilanceve, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme (2017, 2018, 2019).

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se bilancet nuk janë të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve tatimore, bilanci i vitit 2017 është paraqitur fotokopje, si dhe bilanci i vitit 2019 nuk është i plotë.**

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti mallrash, me qëllim transportin e mallit, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- *Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose kontrata e shitblerjes; ose kontrata e dhurimit; ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*

➤ *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*

- *Kontratë huaje.*

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

- *Kontratë qiraje.*

b) Leje qarkullimi e mjetit.

c) Çertifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,

d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,

e) Çertifikate për transport mallrash, për mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka paraqitur Çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor, duke qënë se automjeti është paraqitur si në pronësi të vetë operatorit ekonomik pjesëmarrës.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Operatorin Ekonomik: “**InfoSoft Office**” Sh.p.k, me seli: *Tiranë, Kashar, Kodër Kashar, Autostrada Tirane - Durres, Km 8*, me numër Nipt-i: **J62426002Q**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **798 630.6** (shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë pikë gjashtë) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Mat** me adresë: *Sheshi “Ahmet Zogu”, Nr.1, KP 8001, Burrel*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **888 000** (*tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë*) **lekë pa TVSH**, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **10.03.2021**

Ankesa: **Nuk ka patur.**

Titullari i Autoritetit Kontraktor